



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

02.09.2024, Prishtinë,
Ref:26.07.2024\1548-2024

**Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj
ankesës së Vudi Xhymshiti kundër Reporteri.net**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të mbajtur më 27 gusht 2024, shqyrtoi ankesën e dërguar nga Vudi Xhymshiti kundër Reporteri.net lidhur me publikimin e shkrimit me titull "Skandali i RTK-së: Çka e qysh ndodhi?", dhe mori këtë

V E N D I M

- Ankesa nuk miratohet.

A R S Y E T I M

Media ka publikuar shkrimin me titull "Skandali i RTK-së: Çka e qysh ndodhi?". Pala ankuese pretendon pretendon se artikulli është në kundërshtim me kapitujt I (dispozitat e përgjithshme), II (raportimi i së vërtetës), III (nxitja dhe gjuha e urrejtjes) dhe VII (privatësia) të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës.

Artikulli është publikuar në median online dhe objekt i kësaj ankese është teksti i shkruar, rrjedhimisht ankesa është e lejueshme për trajtim dhe e afatshme.

Pas shqyrtimit të ankesës, KMSHK gjen se ankesa është e pabazuar. Pra, nuk miratohet.

Pas leximit të ankesës dhe pretendimeve të saj, si dhe shkrimit të medias KMSHK ka gjetur se raportimi i medias ka qenë i drejtë, ngase paraqet një kronologji të ngjarjeve që kanë ndodhur. Në fund të artikullit, media përmend shkrimin e medias nga Bosnja dhe Hercegovina dhe faktin që për bazë ka marrë edhe shkrimet e ankuesit. Ky është një fakt notor dhe nuk mund të ndryshojë asgjë, rrjedhimisht ky konstatim nga ana e medias nuk është shkelje e kodit të etikës.

Në lidhje me shkrimin e cituar nga media për ankuesin dhe emisarin amerikan Gabriel Escobar, KMSHK ka marrë vendim më herët.

Andaj, KMSHK vendos që ankesa të mos miratohet.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës